

Prishtinë, 29 maj 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3250_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084); Nenin 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085); Nenin 12, Nenin 14 dhe 17 të Ligjit për Energjinë (Nr. 05/L-081); Nenin 50 të Ligjit për Promovimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Nr. 08/L-258), Nenin 4, Nenin 5, Neni 6, Nenin 7, Nenin 8, Neni 11, Neni 12, Nenin 13, Neni 16, Neni 17, Neni 18, Neni 19 par. 1 dhe Neni 20 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë; Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 84 MW ZK Trestenik, Komuna e Pejës, të datës 08.05.2026 të shoqërisë “Eco Park Group” SH.P.K., me adresë: Madanaj „Qafa “ p.n, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës, dhe Vendimet, lejet dhe pëlqimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në Shtojcën II. të këtij vendimi,

në seancën e mbajtur më 29 maj 2026 nxori këtë:

V E N D I M PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

- I. **APROVOHET - dhe i lëshohet AUTORIZIMI** shoqërisë “Eco Park Group” SH.P.K., me Numër Unik Identifikues (NUI) 810844432 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **84 MW**, sipas Vendimit për Leje Ndërtimore Nr. 5707-2/25 i dt. 07.04.2026 Numri i vrojtimit të lejes: K.III-6/2026 për projektin impiantin fotovoltaik Parku Solar 84 MW, ZK Trestenik, Komuna e Pejës, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr.1371-2/24 i dt. 10.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Vendimin Nr. 1372-2-2/26 i dt. 10.04.2026 për korrigjimin e Vendimit të Pëlqimit Mjedisor Nr.1371-2/24 i dt. 10.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor.
- II. **OBLIGOHET** - shoqëria “Eco Park Group” SH.P.K., që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi, që të dorëzoj garancionin financiar në vlerë prej 7% të vlerës së projektit, të lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar apo kompani e sigurimeve, me vlefshmëri që mbulon periudhën tridhjetë e gjashtë (36) mujore sipas Planin Dinamik të Realizimit të dorëzuar nga Aplikuesi.
- III. Garancioni financiar sipas pikës II. të këtij Vendimi, do të jetë në vlerën prej 2,318,400.00 € (dy milion e treqind e tetëmbëdhjetëmijë e katërqind Euro), sipas vlerës së projektit të prezantuar me Planin e Biznesit, dhe në rast se nuk dorëzohet garancioni financiar në ZRRE brenda afatit ligjor sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij Vendimi, **ky Vendim për Autorizim do të ndërpritet dhe njëkohësisht do të shfuqizohet.**



- IV. Autorizimi sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij Vendimi, i lëshohet shoqërisë “Eco Park Group” SH.P.K., sipas Planit Dinamik të Realizimit, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike.
- V. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
- VI. Leja Mjedisore e lëshuar nga MMPH për projektin Energjetik për Kapacitetet e reja Gjeneruese, do të jetë kusht për fillimin e operimit komercial.
- VII. Shoqëria “Eco Park Group” SH.P.K., për projektin Energjetik para hyrjes në operim komercial, duhet të pajiset me licencë për prodhim të energjisë elektrike nga ZRRE.

Arsyetim

- ZRRE, më 08.05.2026 nga shoqëria “Eco Park Group” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **84 MW**, ZK Trestenik, Komuna e Pejës, sipas VENDIMIT PËR LEJE NDËRTIMORE të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Republika e Kosovës.
- ZRRE me datë 20.05.2026, Njoftimin Publik e ka publikuar edhe në faqen zyrtare të ZRRE-së, në pajtim me Nenin 13 par. 4 të Rregullës në fuqi.
- Shoqëria “Eco Park Group” SH.P.K., me datë 20.05.2026, ka bërë Njoftimin Publik në media të shkruara elektronike, ku ka njoftuar të gjitha palët e interesit se në pajtim me Nenin 8 të Rregullës së Autorizimit ka aplikuar në ZRRE, pas kompletimit të dokumentacionit për marrje të autorizimit, me të cilën palët e interesuara janë njoftuar se vërejtje te tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda tetë (8) ditësh nga data e publikimit.
- ZRRE, brenda këtij afati dhe deri në shqyrtimin e aplikacionit nga Bordi i ZRRE-në, nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo ankesë. Gjithashtu aplikuesi ka dorëzuar edhe pagesën e taksës së shqyrtimit të aplikacionit me datë 26.05.2026 në ZRRE.
- ZRRE, pas analizimit të dëshmive të sjellura sipas Aplikacionit për Autorizim dhe vlerësimin të tyre nga ana e ZRRE-së, ka konsideruar se aplikuesi “Eco Park Group” SH.P.K., i ka plotësuar kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ato ligjore për tu trajtuar dhe pajisur me Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **84 MW**, sipas Vendimit për Leje Ndërtimore Nr. 5707-2/25 i dt. 07.04.2026 Numri i vrojtimit të lejes: K.III-6/2026 për projektin impiantin fotovoltaik Parku Solar 84 MW, ZK Trestenik, Komuna e Pejës, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr.1371-2/24 i dt. 10.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Vendimin Nr. 1372-2-2/26 i dt. 10.04.2026 për korrigjimin e Vendimit të Pëlqimit Mjedisor Nr.1371-2/24 i dt. 10.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor, Marrëveshja e Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit të Kosovës Nr. 1311 dt. 20.05.2025 për stacionin Gjenerues Energjetik me Diell(SGJED) “Terstenik” e lëshuar nga KOSTT SH.A, Dëshmi



mbi të drejtat pronësore, Deklaratën për shitjen e energjisë, Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar, Planin e Biznesit, dhe Plani Dinamik i Realizimit për periudhën tridhjetë e gjashtë (36) mujore.

- o Projekti është në përputhshmëri me strategjinë e energjisë dhe dokumentacionet relevante për zhvillimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.
- o Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura dhe lejeve, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara nga institucionet përgjegjëse, dhe dëshmive administrative, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


VIII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IX. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkëngjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.


Bordi i ZRRE-së:




Ymer Fejzullahu, Kryesues




Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Buçaj, Anëtar



Arta Isufi, Anëtare



Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Pejës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.



SHTOJCA I

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke ushtruar kompetencat e dhëna me Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 17 të Rregullës Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, “Eco Park Group” SH.P.K., me adresë: Madanaj „Qafa “ p.n, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës, më 29 maj 2026, i lëshon këtë:

A U T O R I Z I M

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **84 MW**, sipas Vendimit për Leje Ndërtimore Nr. 5707-2/25 i dt. 07.04.2026 Numri i vrojtimit të lejes: K.III-6/2026 për projektin impiantin fotovoltaik Parku Solar 84 MW, ZK Trestenik, Komuna e Pejës, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr.1371-2/24 i dt. 10.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Vendimin Nr. 1372-2-2/26 i dt. 10.04.2026 për korrigjimin e Vendimit të Pëlqimit Mjedisor Nr.1371-2/24 i dt. 10.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor.
2. Me këtë Autorizim, autorizohet shoqëria “Eco Park Group” SH.P.K., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara Rregullën e Autorizimit.
3. Ky Autorizim lëshohet sipas Planit Dinamik të Realizimit duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE me kërkesë të palës mund ta vazhdoj vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
 - 2.1. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
 - 2.2. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato për mjedisin.
5. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
6. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundoj sipas Nenit 19 par. 1 të Rregullës Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, apo me skadimin e afatit shtesë të përcaktuara nga ZRRE.
7. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërit prej kushteve të këtij Autorizimi dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE do të pezulloj këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit të kushteve ligjore, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.



SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve etj.) të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimit për Ndërtim** të shoqërisë “Eco Park Group” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike – ZK Trestenik, me kapacitet të instaluar prej **84 MW**, Komuna e Pejës, si në vijim:

- Vendimi për Pëlqimin Mjedisor Nr.1371-2/24 i dt. 10.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendimi Nr. 1372-2-2/26 i dt. 10.04.2026 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Pëlqimi nr. 08-350-11348 i dt. 07.02.2024 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Pejës.
- Vendimi Nr. 5707-2/25 i dt. Numri i vrojtimit të lejes: K.III-6/2026 i dt. 07.04.2026 për projektin impiantin fotovoltaik Parku Solar 84 MW, ZK Trestenik, Komuna e Pejës, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Marrëveshja e Kycjes në Rrjetin e Transmisionit të Kosovës, nr. 1311 dt. 20.05. për stacionin Gjenerues Energjetik me Diell(SGJED) “Terstenik” e lëshuar nga KOSTT SH.A,
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore;
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.